

Sesion trajnimi i organizuar nga iCISA – SAI i Indisë mbi Auditimet e Performancës

Në datat 27 qershor - 11 korrik 2023, u zhvillua on-line, trajnimi 10 ditor organizuar nga iCISA (Instituti kryesor i trajnimit të SAI-t të Indisë) me në fokus auditimet e performancës. Ky institut ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të audituesve në të gjithë globin, kryesisht në fushat që lidhen me Auditimin e Performancës dhe analizën e të dhënave.

Ky program trajnimi përmes proceseve hap pas hapi, kishte si synim të përçonte tek pjesëmarrësit aftësi shtesë, të vlefshme në kryerjen e Auditimeve të Performancës duke qenë se ekziston një interes i rinovuar i palëve të interesuara në raportet e këtij lloj auditimi.

Në mjedisin e ri me shumë të dhëna dhe informacion, audituesit publik kërkojnë aftësi për të qenë në gjendje të përdorin në mënyrë efektive informacionin e disponueshëm në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e Auditimit të Performancës duke përdorur teknikat përkatëse të auditimit.

Seancat e ofruara në programin e trajnimit kishin të bënin me disa nga temat si vijon:

- Auditimi i performancës në SAI Indi: Mandati, Evolucionin, Praktikën dhe Përvojën;
- INTOSAI Kuadri i Deklarimeve Profesionale (IFPP) mbi Auditimin e Performancës / ISSAI: Parimet dhe Praktikën;
- Kuptimi i entitetit të biznesit: Një çelës për planifikimin e Auditimit të Performancës;
- Pasqyrë e procesit të auditimit të performancës: planifikimi i auditimit, vlerësimi i auditueshmërisë, vlerësimi i riskut, marrja e të dhënave;
- Përgatitja e udhëzimeve të auditimit të performancës: Përcaktimi i fushëveprimit, kriterëve dhe objektivave, planifikimi i auditimit: Ushtimi mbi matricën e projektimit të auditimit;
- Zbatimi i auditimit: Kryerja e auditimit në terren, mbledhja e të dhënave të auditimit, Vlerësimi i të dhënave të auditimit;
- Kryerja e Auditimit: Nxjerrja e konkluzioneve të auditimit dhe përgatitja e raportit të auditimit të performancës;
- Auditimi i Performancës në Sektorin Tregtar: Një rast studimor;
- Auditimi i Performancës së Sektorit të të Ardhurave;
- Auditimi i Performancës së Sistemeve të Informacionit (GUID 5100) dhe Studim Rasti;
- Auditimi i performancës me perspektivë mjedisore / zhvillimi i qëndrueshëm: Rast studimor (Ruajtja e ekosistemit bregdetar detar);
- Auditimi i performancës në ndërtimin e rrugëve: një rast studimi;

- Auditimi i performancës së privatizimit: Udhëzues (GUID 5320) dhe Studim Rasti (Projekti PPP në Aeroportin CSI, Mumbai);
- Auditimi i performancës për Fuqizimin e Grave: Një rast studimor;
- Auditimi i Performancës në Sektorin e Arsimit;
- Përdorimi i Remote Sensing/GIS në auditim;
- Auditimi i Performancës në Furnizimin me Ujë: Një rast studimor;
- Auditimi i Performancës së Prokurimit Publik: Udhëzues (GUID 5280 (propozuar) dhe Rast Studimi;
- Hyrje në analizën e të dhënave në auditim;
- Auditimi i Performancës – Rast Studimi mbi Auditimin në Mjedisin e TI-së (Data Centric;)
- Aplikimi i mjetit të analizës së të dhënave KNIME në auditim;
- Vizualizimi duke përdorur mjetin e analizës së të dhënave: Tableau;
- Aplikimi i teknologjive në zhvillim në auditim: - Inteligenca Artificiale;

Përgjatë ditëve të trajnimit, sesionet u zhvilluan në mënyrë interaktive ndërmjet 28 pjesëmarrësve nga 11 vende të ndryshme të botës.

Pjesë përbërëse e programit të trajnimit shumëpalësh e-ITEC ishin dhe prezantimet nga vendet pjesëmarrëse nëpërmjet të cilave mësohej më shumë për Institucionet Supreme të Auditimit respektive dhe vendet e njëri-tjetrit.

Prezantimi i KLSH-së pati në fokus:

- Një përmbledhje rreth vendit tonë: Ekonomia, Qeverisja, Kultura, Turizmi, etj.;
- Informacion të përgjithshëm mbi mënyrën e funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Struktura organizative, mandati;
- Llojet e auditimit që kryen KLSH;
- Statusi i Auditimit të Performancës në KLSH duke përfshirë aplikimin e mjeteve të ndryshme të analizës së të dhënave në auditim;
- Sfidat që po hasen gjatë Auditimit të Performancës, etj.;

Nga KLSH këtë trajnim e ndoqën auditueset e Departamentit të Auditimit të Performancës, Arminda Bushi dhe Vjola Kojani.